



VENDIM

Nr. 10, Datë 06.12.2013

MBI

**KËRKESEN E SHOQËRISË KESH SH.A PËR RINOVIMIN E
LIÇENSËS NE AKTIVITETIN E FURNIZUESIT PUBLIK ME
SHUMICË**

Në mbështetje të neneve 9; 13 pika 1 gërma “ç” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar; neneve 7; 149 dhe 150 të Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999, “Kodi i Proçedurave Administrative”, neneve 4 pika 1 gërma “d”; 5 pika 1 gërma “d”; 16 të “Rregullores për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit te liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.02.2014, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a për Rinovimin e Liçensës në Aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumicë,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH Sh.a”, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Rinovimin e liçencës së shoqërisë “KESH”sh.a, në aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumicë të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 59, datë 03.06.2008, me një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 10, Datë 06.12.2013

**MBI
KËRKESEN E SHOQËRISË KESH SH.A PËR RINOVIMIN E
LIÇENSËS NE AKTIVITETIN E FURNIZUESIT PUBLIK ME
SHUMICË**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____